



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.118/6 Prot.

Tiranë, më 15 .08. 2022

V E N D I M

Nr. 159, Datë 15.08. 2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr.12 regj, datë 17.01.2022, paraqitur nga ankuesi I.B, kundër Shkollës Jopublike Medreseja “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”, “*bindjeve fetare*” dhe “*përkatësisë familjare*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi I.B shpjegon se punon si mësues fiskulture në Medresenë “*Haxhi Sheh Shamia*”, Dega e Djemve në Shkodër që nga viti 2009 dhe në vazhdim (*prej të cilave gjashtë vite si mësues me kohë të plotë*) dhe mësues i parë dhe i vetëm gjatë katër viteve në këtë shkollë. Më datë 11.08.2021 ankuesi deklaroi se, i është komunikuar verbalisht nga drejtuesit e Shkollës për ardhjen e një mësuesi të ri dhe shkurtimin e orëve të tij të punës nga 21 orë mësimore në 6 orë mësimore, duke kaluar automatikisht nga mësues i parë në mësues i dytë (në normativë orësh mësimore). Sipas ankuesit, mësuesi i ri z.K.H, aktualisht nuk zotëron licencën e mësimdhënies.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar në vendin e punës për shkak të gjendjes arsimore, pasi ai ka të drejtën që të ushtrojë mësimdhënien me kohë të plotë, ndërsa ata që diplomohen me ligjin e ri të arsimit të lartë duhet t’i nënshtrohen provimit të licencës, për të patur të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit. Sipas ankuesit ky përbën diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, sepse mësuesi i ri që ka ardhur në shkollë nuk mund t’a ushtrojë profesionin, pasi nuk ka licencë dhe për të plotësuar orët e tij, kanë ulur numrin e orëve të ankuesit. Gjithashtu, sipas tij, nuk është zhvilluar asnjë procedurë korrekte për të vlerësuar dosjen e tij profesionale, por thjesht i janë ulur orët dhe paga që nga muaji tetor, pa asnjë njoftim zyrtar. Sipas tij, diskriminimi qëndron në faktin se ai

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri”.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën “LMD”.

gëzon të drejtën ligjore që të ketë orë të plota mësimore dhe shkolla me qëllim futjen e një mësuesi të ri, i cili nuk zotëron licencën për ushtrimin e profesionit të mësuesit sipas ligjit, ka ulur orët e tij mësimore. Ankuesi thekson se, nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument, por e gjitha i është komunikuar në formë verbale.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin e orëve të plota mësimore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1, të LMD, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 4, pika 1, nenit 33, pika 1, të LMD dhe nenit 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, që t’i drejtohet Komisionerit me ankesë dhe ka provuar interesin e tij të drejtëpërdrejtë përsa i takon pretendimit për cënim të parimit të barazisë e mosdiskriminimit.

Subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, Shkolla Jopublike Medreseja “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër, në cilësinë e punëdhënësit, është një institucion privat i arsimit parauniversitar, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare. Medreseja “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër është një institucion i arsimit parauniversitar themeluar nga Komuniteti Musliman Shqiptar (KMSH).

Në datën 30.07.2007, KMSH ka nënshkruar një Protokoll Bashkëpunimi me Shoqatën Istanbul, për bashkëpunim në fushën e arsimit, edukimit, kulturës dhe aktiviteteve të ndryshme humanitare, për një periudhë kohore prej 20 (njëzetë) vjetësh. Ndër të tjera, në këtë Protokoll Bashkëpunimi, është dakortësuar që Shoqata Istanbul do të marrë përsipër administrimin e procesit edukativo-mësimor në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia”, Dega e Djemve Shkodër. Në lidhje me Medresenë “Haxhi Sheh Shamia”, palët kanë dakortësuar ndër të tjera, se, drejtori i shkollës, i cili emërohet nga KMSH me pëlqimin e Shoqatës Istanbul, ndjek marrëdhëniet zyrtare, kurse procesi edukativo – arsimor, udhëhiqet nga koordinatori i cili caktohet nga Shoqata Istanbul. Ndërsa, zgjedhja e kuadrit

arsimor, sipas protokollit të Bashkëpunimit, bëhet brenda kritereve të përcaktuara mes dy palëve dhe se personeli është nën kompetencat dhe përgjegjësinë e koordinatorit.

Medreseja “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër, është një institucion i arsimit parauniversitar dhe si i tillë, pavarësisht faktit se është një institucion arsimor privat, funksionon sipas ligjit nr.69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar (në vijim ligji nr.69/2012), përveç rasteve kur ligji ka formulim të veçantë për institucionet arsimore publike, si edhe akteve nënligjore të nxjerra në mënyrë specifike për to.

Bazuar në ligjin nr. 69/2012, të ndryshuar, Rregulloren për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr.31, datë 28.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Rregullores së Brendshme të Shkollës, Medreseja “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër, si një institucion i arsimit parauniversitar, ka personalitet juridik dhe përfaqësohet në marrëdhënie me të tretët nga drejtori i shkollës. Marrëdhëniet e brendshme të varësisë ose të ndërveprimit midis shkollës dhe Shoqatës Istanbul, në cilësinë e administratorit dhe financuesit të këtij institucioni arsimor, janë çështje të brendshme të shkollës, e cila është subjekti që mbart të drejta dhe detyrime në marrëdhënie me të tretët, përfshi këtu edhe ankuesin në cilësinë e punëmarrësit. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se në marrëdhënien e punës objekt shqyrtimi, cilësinë e punëdhënësit e ka Medreseja “*Haxhi Sheh Shamia*”, Shkodër, si institucion privat i arsimit parauniversitar.

Sa më sipër, Komisioneri konsideron se kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis individit dhe një subjekti privat, që në rastin në fjalë është Shkolla Jopublike Medreseja “*Haxhi Sheh Shamia*”, Shkodër, marrëdhënie e cila hyn në fushën e veprimit të LMD.

Ankuesi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të nenit 33, pika 4, shkronja “dh”, të LMD-së, në të cilin parashikohet se : “4. Ankesa nuk pranohet nëse: dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e dëgjimit për sjelljen diskriminuese.”, pasi ulja e orëve mësimore që pretendohet nga ankuesi si sjellje diskriminuese, ka ndodhur në shtator të vitit 2021 që shënon fillim e vitit shkollor 2021-2022, ndërsa ankesa pranë Komisionerit është regjistruar në datën 17.01.2022.

Ankuesi legjitimohet *ratione materia*, pasi pretendimet e tij janë të tilla që bëjnë pjesë në kompetencat që ligji, i njeh Komisionerit për shqyrtimin e ankesës në kuptim të nenit 32, pika 1, shkronja “a”, të LMD-së, ku përcaktohet se: “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;”

Referuar nenit 33, të LMD, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj për pranimin e saj dhe shqyrtimin në themel të pretendimeve të parashtruara nga pala ankuese. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.118/1 prot., datë 03.02.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shkolla Jopublike Medreseja “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër (në vijim Medreseja), në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
2. Me shkresën nr.152 prot., datë 10.02.2022³, Medreseja ktheu përgjigje duke parashtruar si më poshtë:

Medreseja “*Haxhi Sheh Shamia*” është shkollë e mesme e bashkuar dhe ofron shërbim arsimor parauniversitar në dy cikle 9 vjeçar dhe gjimnaz. Me plan mësimor të miratuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (K.M.SH) dhe MASR, ku 80 % e lëndëve janë të përgjithshme dhe 20 % janë fetare. Medreseja e Shkodrës ka 1060 nxënës në 50 klasa dhe aktualisht është ndër shkollat më të mëdha të vendit dhe njëkohësisht Medreseja më e madhe në Shqipëri. Shkolla synon të përgatisë nxënës me dashuri për atdheun dhe besimin islam, të aftë të përballojnë sfidat e kohës, në shërbim të demokracisë, përparimit dhe zhvillimit fetar shoqëror. Është shkollë që mbështet filozofinë kombëtare dhe fetare të besimit Islam dhe ka synim të qartë European. Është shkollë e monitoruar nga institucionet arsimore, si ZVA, DAR Shkodër, Inspektoriati Kombëtar i Arsimit dhe është vlerësuar shumë mirë. Po kështu është monitoruar herë pas herë edhe nga KMSH.

Për rezultatet e larta është vlerësuar me çertifikata, tituj, urdhëra e medalje të ndryshme, si nga Bashkia dhe Qarku Shkodër, nga institucionet vendore dhe rajonale të arsimit, nga Presidenti i Republikës, nga Bashkësitë Fetare në Stamboll, në Republikën e Maqedonisë, të Kosovës, në Preshevë etj, përfshirë këtu edhe falenderime nga Presidenti i Republikës së Turqisë, Rexhep Taip Erdogan.

Në fillimin e vitit shkollor 2021-2022, është hartuar ngarkesa mësimore lëndore, me synim mbulimin me kuadër të të gjithë lëndëve të planit mësimor, në AMU dhe AML. Koordinator i Shoqatës “Istanbul” dhe drejtorja kanë bërë disa ndryshime në aspektin numerik të ngarkesës mësimore të disa mësuesve, në funksion të planit mësimor të shkollës dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër, është parë e arsyeshme që të bëhet një ndryshim në ngarkesën mësimore të mësuesve që japin lëndën e edukimit fizik në shkollë, të cilët janë z. I.B dhe z.K. H. Konkretisht:

Mësuesi I.B, në vitin shkollor 2020-2021 ka pasur 20 orë mësimore në javë, ndërsa këtë vit shkollor 2021-2022 ka 5 orë mësimore në javë të cilat i bën në gjimnaz dhe paguhet 47.700 lekë bruto; *Mësuesi K.H*, në vitin shkollor 2020-2021 ka patur 2 orë, ndërsa në vitin shkollor 2021-2022 ka 18 orë mësimore, të cilat i zhvillon në 9-vjeçare dhe paguhet 66.590 lekë bruto.

Ky ndryshim është bazuar në kontributin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm të familjes së z. K.H dhe konkretisht gjyshit të tij, të ndjerit F.H, Myftiu i parë i qytetit të Shkodrës, i cili menjëherë pas rënies së komunizmit dhe rihapjes së besimit fetar dhe ngritjes së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në vitin 1991 ishte nismëtar i themelimit të Medresesë së Shkodrës, medrese e parë në Shqipëri. Gjithashtu, Myftiu i Shkodrës, ishte ndër themeluesit e Shoqatës “Istanbul” dhe një nga mbështetësit kryesor të saj, shoqatë e cila ka dhënë dhe jep një kontribut të madh në ndihmë të

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 118/2 prot., datë 14.02.2022.

njerëzve në nevojë dhe në drejtim të veprimtarive humanitare, kulturore, edukative dhe arsimore, në të gjithë Qarkun e Shkodrës dhe më gjerë. Gjithashtu Shoqata "Istanbul" mori përsipër administrimin, financimin dhe drejtimin e Medresesë së Shkodrës (Dega Vajza) qysh nga viti 2001 dhe më pas nga viti 2007 e në vazhdim edhe Medresenë e Djemve. Kjo sipërmarrje është shoqëruar me investime të fuqishme siç janë: Dy godinat shkollore të degës së Vajzave (për ciklin 9-vjeçar dhe gjimnazin); Konvikti i Degës së Djemve dhe të Vjazave; Xhamia e Medresesë; Konvikti i Hafizëve të Kur'anit. Gjithashtu, Shoqata "Istanbul" financon 100 % bazën materiale, didaktike dhe laboratorike të Medresesë etj, si dhe pagesën e 94 arsimtarëve dhe 30 punonjësve jo mësimorë.

Në institucionin tonë arsimor, për zgjedhjen e kuadrit mësimor, kriter parësor i performancës është edhe morali Islam që ka çdo punonjës. Z.K.H i plotëson këto kriterë. Duke ju përgjigjur pretendimit të z.I.B, mësuesi K.H, pas përfundimit të Masterit Profesional në mësuesi në lëndën e Edukimit Fizik, në shtator të vitit 2020, e kemi parë të arsyeshme t'a testojmë, duke i dhënë dy orë mësimi. Njëkohësisht i kemi vënë si detyrë marrjen e licensës, për të cilën ai ka deklaruar se ka hyrë në procedurë, por ka pasur ngadalësim për shkak të Covid-19. Ndërkohë që mësuesi I.B ka patur mangësi në përgatitjen e orëve mësimore dhe të dokumentacionit shkollor.

Në këto kushte, ndryshimi i pozicioneve të punës dhe qarkullimi i personelit, është praktikë normale në çdo institucion, që lidhet edhe me performancën e punonjësve, formimin e tyre qytetar, profesional dhe fetar dhe nuk ka lidhje me asnjë element diskriminimi për asnjë lloj arsye.

3. Në datën 27.02.2022, ankuesi ka dërguar nëpërmjet postës elektronike (*me e-mail*), kundërshtimet e tij në lidhje me qëndrimin e depozituar nga Medreseja, duke parashtruar ndër të tjera si vijon:

Ankuesi punon si mësues fiskulture në shkollë dhe jo punonjës fetar. Vlerësimi i performancës, duhet të bëhet mbi kriterë objektive dhe të pabazuara në ligj (nga një komision). Pretendimi se nuk plotëson kriterin e performancës fetare, është subjektiv dhe totalisht në kundërshtim me ligjin për diskriminimin.

Pretendimi për mangësi në dokumentacionin mësimor nuk qëndron, sepse në asnjë moment nuk ka patur asnjë vërejtje nga drejtoria mësimore. Gjithsesi, ky pretendim bie ndesh me deklaratimet e bëra nga institucioni në shkresën e dërguar, ku deklarohet se kanë ndryshuar kontratën për shkaqe fetare dhe të përbërjes familjare të kandidatit K.H. Drejtoria e shkollës pranon se K.H nuk ka licensën për të dhënë mësim, kriter i cili është detyrim ligjor për arsimin parauniversitar dhe shkolla nuk ka tagër ligjor që të interpretojë ose ndryshojë ligjin.

Për këto arsye, për shkak se drejtoria ka pranuar me shkresë zyrtare se ndryshimi i kontratës ka ndodhur për këto shkaqe jo ligjore, ankuesi pretendon se është diskriminuar, për shkak të gjendjes arsimore, bindjeve fetare dhe për shkak të përkatësisë familjare, dhe se kjo përbën një formë të rëndë diskriminimi.

4. Me shkresën nr.118/3 prot., datë 16.03.2022, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion nga Medreseja, në lidhje me peretendimet shtesë të paraqitura ankuesi, për diskriminim për shkak

të bindjeve fetare dhe përkatësisë familjare. Medreseja nuk ktheu përgjigje në lidhje për shkresën e sipërcituar.

5. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet se : *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”*, si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 19.04.2022.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datë 19.04.2022, me pjesëmarrjen e të dy palëve të përfshira në procedurën administrative. Për palën ankuese, u paraqit personalisht ankuesi I.B. Medreseja “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër, u përfaqësua nga z.K.D, Drejtor i Shkollës, z.R. S, Kryetar i Shoqatës Istanbul, z.F.D, Koordinator i Shoqatës Istanbul dhe z.A.H, jurist i Shoqatës Istanbul.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan parashtresave me shkrim të depozituara paraprakisht pranë Komisionerit.

Ankuesi, paraqiti gjatë seancës dëgjimore një pretendim shtesë. Ai parashtroi se, rreth datës 15 shkurt 2022, mësuesi K.H ishte larguar nga shkolla dhe me largimin e tij orët mësimore të fiskulturës, nuk i kishin kaluar ankuesit, por i ishin dhënë një punonjësi të shërbimit, i cili nuk ka arsimin përkatës.

Gjatë seancës dëgjimore dhe bazuar në nenin 33, pika 9, të LMD, ku përcaktohet se: *9. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.”*, palëve ju parashtrua mundësia për arritjen e një marrëveshje dhe zgjidhjen e çështjes me pajtim.

Ankuesi deklaroi se me rikthimin e orëve mësimore ai e konsideronte problematikën e tij të zgjidhur dhe hiqte dorë nga ankesa e paraqitur. Përfaqësuesve të Medresesë, i'u la kohë që të shpreheshin brenda 10 ditëve, nëse ishin dakort që të rregullonin situatën duke i rikthyer ankuesit orët mësimore.

Në vijim të seancës dëgjimore Medreseja nuk dërgoi asnjë përgjigje në lidhje me kërkesën për arritjen e një marrëveshje pajtimi, sipas parashikimit të nenit 33, pika 9 të LMD.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të disfavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, ankuesi I.B, është i punësuar si mësues i edukimit fizik, pranë Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër. Marrëdhëniet e punës midis ankuesit dhe Medresesë janë lidhur në datën 01.12.2009, fakt ky që rezulton i provuar në bazë të librezës së punës. Sipas deklarimeve në seancë dëgjimore nga ana e

përfaqësuesve të Medresesë, në vitin 2015 ankuesi ka kaluar si mësues definitiv. Ky fakt nuk u kundërshtua prej ankuesit.

Marrëdhëniet e punësimit midis ankuesit I.B dhe Medresesë janë rregulluar në bazë të kontratës individuale të punës të nënshkruar nga palët në datën 01.09.2018. Nuk u administruan akte të tjera me shkrim mbi bazën e të cilave janë rregulluar marrëdhëniet e punës përpara kësaj date dhe as akte të mëvonshme, pas datës 01.09.2018. Në bazë të kontratës individuale të punës të datës 01.09.2018, rezulton se ankuesi është punësuar si mësues i edukimit fizik, në ciklin 9-vjeçar dhe të mesëm, pranë Medresesë “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër, Dega e Djemve, me një ngarkesë mësimore (maksimale) 21 orë në javë. Kontrata është lidhur për një afat kohor të pacaktuar dhe paga bruto 58.310 (pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e dhjetë) lekë në muaj.

Bazuar në dokumentacionin e administruar, rezulton se ankuesi I.B, ka përfunduar studimet në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “*Vojo Kushi*” Tiranë në vitin 2009, në përfundim të të cilave ka fituar titullin “*Mësues i Edukimit Fizik*” i profilizuar “*Në Sporte Ndeshës*”.

Referuar shkresës nr.755 prot datë 10.02.2022 të lëshuar nga Medreseja, deri në vitin shkollor 2018-2019, Medreseja “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër ka patur vetëm një mësues të edukimit fizik për Degën e Djemve, dhe ai ka qenë ankuesi.

Në 12.11.2019, në Medresenë “*Haxhi Sheh Shamia*”, Shkodër ka filluar punë si mësues i edukimit fizik, në Degën e Djemve, mësuesi K.H, fakt ky që rezulton i provuar nga librezja e punës. Në bazë të deklarimeve të palëve të bëra gjatë seancës dëgjimore, gjatë vitit shkollor 2019-2020 mësuesi K.H ka patur 2 (dy) orë mësimore.

Gjatë vitit shkollor 2020-2021, ankuesi I.B ka patur 20 (njëzetë) orë ngarkesë mësimore në javë dhe është paguar me një pagë bruto 61.800 (gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind) lekë në muaj, referuar shkresës nr.754 prot datë 10.02.2022, lëshuar nga shkolla. Ndërsa mësuesi K.H gjatë këtij viti mësimor ka vazhduar të ketë të njëjtën ngarkesë, 2 (dy) orë mësimore në javë.

Në datën 11 gusht 2021, ankuesit i është komunikuar në mënyrë verbale nga koordinatori i Shoqatës Istanbul pranë Medresesë, se Bordi i Shoqatës kishte vendosur që për vitin mësimor 2021-2022 ai do të jepte orët e edukimit fizik në gjimnaz 5 (pesë) ose 6 (gjashtë) orë mësimore në varësi të ngarkesës, ndërsa orët mësimore të edukimit fizik në 9-vjeçare, 18 (tetëmbëdhjetë) orë mësimore, do ti merrte mësuesi K.H. Ankuesit nuk i është bërë ndonjë njoftim me shkrim në lidhje me ndryshimet e propozuara. Ankuesi nuk ka qenë dakort me këtë ndryshim të ngarkesës mësimore dhe ka kërkuar arsyet dhe dokumentacionin mbi bazën e të cilit është bërë ky ndryshim. Ankuesi e ka paraqitur këtë kërkesë në mënyrë verbale dhe nuk rezulton që të ketë depozituar ndonjë kërkesë me shkrim.

Ankuesi e kundërshtoi pretendimin e përfaqësuesve të Medresesë, se atij i ishte paraqitur për nënshkrim kontrata me kushtet e reja, ndërsa shkolla nga ana e saj nuk arriti të provojë pretendimin

e saj se ankuesi kishte refuzuar nënshkrimin e kontratës së re. Referuar kontratës individuale të punës me datë 01.09.2021, të depozituar nga ana e Medresesë, dokument i cili është nënshkruar vetëm nga përfaqësuesit e shkollës, por jo nga ana e ankuesit, rezulton se, shkolla, ka parashikuar që ankuesi nga mësues me kontratë me afat të pacaktuar të kalonte në mësues me kontratë me afat të caktuar, afat i cili sipas kontratës së re do të ishte deri në datën 31.08.2022 dhe ankuesi do të kishte një ngarkesë mësimore prej 5 (pesë) orë mësimore në javë.

Gjatë vitit shkollor 2021-2022 dhe pas ndryshimeve në ngarkesën mësimore, ankuesi ka vazhduar punën si mësues i edukimit fizik në gjimnaz, me një ngarkesë prej 5 orë mësimore në javë dhe është paguar me pagë mujore bruto prej 47.700 (dyzetë e shtatë mijë e shtatëqind) lekë në muaj, fakt ky që rezulton sipas shkresës nr.754 prot datë 10.02.2022, të depozituar nga drejtori i Medresesë. Ndërsa mësuesi K.H, gjatë vitit shkollor 2021-2022 rezulton të ketë patur ngarkesë prej 18 (tetëmbëshjetë) orë mësimore në ciklin 9-vjeçar, fakte këto që rezultojnë sipas shkresave nr.753 prot dhe nr.755 prot., datë 10.02.2022, të drejtorit të Medresesë.

Ankuesi ka vazhduar punën sipas ngarkesës së re mësimore të reduktuar, por duke pretenduar se zbritja e ngarkesës së tij mësimore ka ndodhur për shkaqe diskriminuese, ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr.12, datë 17.01.2022. Fillimisht, ankuesi pretendoi se është diskriminuar nga Medreseja “Haxhi Shesh Shamia” Shkodër për shkak të gjendjes arsimore, pasi ai zotëron të gjitha të drejtat për të dhënë mësim me kohë të plotë dhe është i pajisur me licensën e mësimdhënies, ndërsa mësuesi K.H, nuk zotëron licensë për të ushtruar profesionin e mësimdhënies, sipas ligjit. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, ankuesi shtoi si shkak të pretenduar të diskriminimit shkakun e “*bindjeve fetare*” dhe “*përkatësisë familjare*”. Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 19.04.2022, ankuesi shtoi pretendimet e tij, duke parashtruar se, pas largimit të mësuesit K.H nga shkolla, kjo e fundit nuk i kishte dhënë orët e lira mësimore të mbetura pas largimit të tij, por ia kishte kaluar ato një punonjësi i cili ishte jashtë profilit.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.*

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i këtij ligji si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të LMD.*

Në Kreun II, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD, në nenin 12/1/c, përcakton se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e*

përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose disa nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga LMD.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesi i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim në lidhje me zbritjen e orëve mësimorë. Nëse konstatohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, atëherë do të vijohet me analizën, nëse ky trajtim të cilit i është nënshtruar ankuesi ka ardhur apo jo si rezultat i shkaqeve të pretenduara, të cilat duhet gjithashtu të provohen dhe gëzojnë mbrojtje nga ligji.

- Në lidhje me pretendimin për zbritjen e orëve mësimore në vitin shkollor 2021-2022.

Gjatë vitit shkollor 2019-2020 dhe 2020-2021, pavarësisht se me ardhjen e mësuesit të ri të edukimit fizik K.H me një ngarkesë prej 2 (dy) orë mësimore në javë, ankuesi nuk është ndjerë i cënuar në të drejtat e tij dhe ka vazhduar punën normalisht.

Sipas nenit 12, të Kodit të Punës, kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënësi, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim.

Në nenin 21, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë. 2. Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëdhënësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës.”.* Sipas pikës 3,

të po këtij neni, disa nga elementët e domosdoshëm të kontratës së punës janë përshkrimi i përgjithshëm i punës, kohëzgjatja e kontratës, koha normale javore e punës dhe paga.

Bazuar në nenin 21, pika 4, të Kodit të Punës, përcaktohet se: *“4. Për raste të veçanta dhe të justifikueshme, nëse kontrata nuk është lidhur sipas pikave 1 dhe 3, të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar ta lidhë atë brenda 7 ditëve nga dita e punësimit.”*

Sa më sipër rezulton se, kontrata e punës lidhet me shkrim, por ekzistenca e marrëdhënies së punës nuk çenohet, në rastet kur palët nuk kanë lidhur kontratën e punës në formën e shkruar, në kushtet kur provohet ekzistenca e marrëdhënies juridike të punësimit midis palës punëdhënëse dhe asaj punëmarrëse. Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëdhënësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës. Ndryshimi i kontratës së punës bëhet me dakortësinë e palëve, punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimi rezulton se, ankuesi ka patur një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe me një kohëzgjatje javore pune prej 21 (njëzetë e një) orë mësimore (maksimale). Me fillimin e vitit shkollor 2021-2022, kontrata ekzistuese e punës e ankuesit ka ndryshuar në disa elementë thelbësorë të saj, sikurse janë kohëzgjatja javore e punës, e cila nga 18 (tetëmbëdhjetë) orë mësimore (efektive) në vitin paraardhës (2020-2021), ka shkuar në 5 (pesë) orë mësimore. Ky ndryshim në ngarkesën mësimore është shoqëruar edhe me ndryshime në pagën mujore të ankuesit. Rezulton se, nga një pagë bruto prej 61.800 (gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind) lekë në muaj të përfituar nga ankuesi gjatë vitit shkollor 2020-2021, ai ka pësuar zbritje në pagë, duke u paguar për vitin shkollor 2021-2022, me një pagë mujore bruto prej 47.700 (dyzetë e shtatë mijë e shtatëqind) lekë.

Ankuesi ka vazhduar të kryejë punën si mësues i edukimit fizik, sipas ngarkesës mësimore të dhënë nga shkolla, punë të cilën e ka kryer kundrejt shpërblimit. Megjithatë, ankuesi pretendon se, ulja e ndarkesës së tij mësimore nuk ka një arsye të ligjshme, por ka ndodhur për shkaqet diskriminuese të pretenduara prej tij.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Medreseja parashtroi se, ndryshimi i pozicioneve të punës, qarkullimi i personelit dhe ndryshimet në ngarkesën mësimore të mësuesve, ishin një proces normal dhe se ndryshimi kishte ndodhur pasi kështu ishte parë e arsyeshme. Pavarësisht se shkolla pretendoi se ankuesi kishte patur mangësi në mbajtjen e dokumentacionit shkollor, nuk arriti ta provojë pretendimin me anë të provave, ndërsa ankuesi e kundërshtoi këtë fakt të pretenduar prej punëdhënësit. Nga ana tjetër, shkolla pranoi se, mangësitë e konstatuara nuk kishin shërbyer si shkak për ndryshimin e ngarkesës mësimore të ankuesit. Shkolla, pranoi gjithashtu se, ulja e orëve mësimore të ankuesit nuk kishte ardhur si pasojë e rënies së numrit të nxënësve dhe ngarkesës mësimore.

Rezulton se ngarkesa totale mësimore në shkollë nuk ka pësuar ndryshime, pasi orët mësimore gjatë vitit shkollor 2021-2022 janë të ngjashme me ato gjatë vitit shkollor 2020-2021. Bazuar në faktet dhe rrethanat e provuara në bazë të provave të administruara rezulton se, orët mësimore që i janë ulur ankuesit, i kanë kaluar mësuesit K.H. Në datën 01.09.2021, Medreseja “*Haxhi Shesh Shamia*” ka nënshkruar me mësuesin K.H kontratën individuale të punës me afat të pacaktuar duke përcaktuar një ngarkesë mësimore (maksimale) prej 18 (tetëmbëdhjetë) orë mësimore në javë, nga 2 orë mësimore që ka patur gjatë 2 (dy) viteve të mëparshme (2019-2020 dhe 2020-2021).

Mësuesi K.H, ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Shkencave të Edikimit Fizik, pranë Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” në përfundim të të cilave ka fituar Diplomë Bachelor në “*Edukim Fizik e Sporte*”, lëshuar në datën 04.10.2018. Mësuesi K.H ka përfunduar studimet universitare në ciklin e dytë të studimeve pranë Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” dhe është pajisur me Diplomë Master Profesional “Mësuesi në edukim fizik e sporte”, lëshuar në datën 3.8.2020. Mësuesi K.H nuk rezulton të ketë kryer provimin e shtetit siç parashikohet në ligjin nr.10 171, datë 22.10.2009, “*Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë*”, një detyrim ligjor i parashikuar nga ligji nr.69/2012, i ndryshuar, për të ushtruar profesionin e mësuesit. Ky fakt jo vetëm që nuk u kundërshtua, por u konfirmua dhe u pranua edhe nga Medreseja.

Komisioneri vlerëson se, ndryshimet në elementë ose kushte të caktuar të marrëdhënies së punësimit, janë procese normale edhe kur nuk ndodhin me dakortësinë palëve, për sa kohë që ndryshimet rezultojnë të kenë ndodhur për arsye ligjore dhe objektive. Në rastin konkret, Komisioneri nuk konstatoi asnjë arsye ligjore ose objektive për zbritjen e ngarkesës mësimore të ankuesit në 5 (pesë) orë mësimore në javë.

Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, zbritja e orëve mësimore të ankuesit I.B, nuk ka ndodhur bazuar në arsye ligjore dhe objektive. Në këto kushte provohet se ankuesi I.B, është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme.

- **Në lidhje me moskalimin e orëve të lira mësimore të edukimit fizik, pas largimit nga puna të mësuesit K.H.**

Gjatë seancës dëgjimore ankuesi pretendoi se në mënyrë të padrejtë, shkolla nuk i kishte kaluar orët mësimore të edukimit fizik të cilat rezultuan të lira pas largimit të mësuesit K.H, në muajin shkurt 2022, duke ia kaluar në mënyrë të pabazuar një personi të shërbimit, i cili nuk ishte i profilit.

Në lidhje me këtë pretendim të ngritur nga ankuesi dhe bazuar në deklaratimet e bëra nga përfaqësuesit e Medresesë gjatë seancës dëgjimore, rezultoi se, mësuesi K.H ishte larguar me dëshirën e tij nga Medreseja në datën 15 shkurt 2022. Shkolla ka vendosur që orët e lira të edukimit fizik, pas largimit të mësuesit K.H, deri në përfundimin e vitit shkollor, t’ia kalojë një punonjësi të shkollës, z.E.K, duke vlerësuar angazhimin e këtij të fundit. Përfaqësuesit e Medresesë deklaruan gjatë seancës dëgjimore se z. E.K, ishte jashtë profilit të edukimit fizik dhe nuk dhanë sqarime të mëtejshme në lidhje me personin (apo “angazhimin” e tij) të cilit i kishin kaluar orët mësimore të edukimit fizik.

Bazuar në deklaratimet e bëra nga palët gjatë seancës dëgjimore, Komisioneri konstaton se, pas largimit nga puna të mësuesit K.H, orët e lira mësimore të edukimit fizik, nuk i kanë kaluar ankuesit, i cili ishte mësues i profilit, por një punonjësi tjetër jashtë profilit. Rezulton se, orët mësimore të edukimit fizik që jepeshin nga mësuesi K.H ishin orë mësimore të edukimit fizik në arsimin e mesëm të ulët (cikli 9-vjeçar).

Në bazë të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon arsimin parauniversitar dhe në mënyrë të veçantë udhëzimit nr.30, datë 12.09.2018 të Ministrit të Arsimit “*Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar*”, të ndryshuar, parashikohet se, orët mësimore të lëndës “*Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndetit*” në arsimin e mesëm të ulët (klasat VI-IX) duhet të jepen nga mësues të profilit “Edukim fizik” ose profili i përafërt “*Mësues i Fiskulturës shkalla I e kualifikimit sipas përcaktimeve të ligjit nr.69/2012, të ndryshuar.*”

Komisioneri konstaton se, ankuesi I.B, vazhdonte të ishte mësues i edukimit fizik në ciklin e mesëm të lartë, me një ngarkesë mësimore jo të plotë, vetëm 5 (pesë) orë mësimore dhe me një eksperiencë të konsiderueshme, pasi kishte dhënë prej vitesh që prej vitit 2009 lëndën e edukimit fizik në Medresenë “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër, në të dy ciklet, si në arsimin e mesëm të ulët ashtu edhe në arsimin e mesëm të lartë. Rritja e ngarkesës mësimore do të shoqërohej për ankuesin edhe me rritje të pagës (e cila kishte pësuar ulje për shkak të rënies së numrit të orëve mësimore) por do të krijonte edhe kushte më të favorshme për ankuesin lidhur me vijimësinë e punës duke patur një ngarkesë të plotë mësimore.

Në këto kushte Komisioneri vlerëson se, orët mësimore të lira pas largimit të mësuesit K.H duhet t’i kishin kaluar ankuesit I.B, si mësuesi i vetëm i edukimit fizik në Medresenë “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër dhe jo t’i kalonin një mësuesi jashtë profilit.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin, se ankuesi I.B i është nënshtruar një trajtimi të disfavorshëm, duke mos i kaluar orët e lira mësimore të edukimit fizik, pas largimit të mësuesit K.H.

B. Shkaku i mbrojtur

Ankuesi pretendon se është diskriminuar për më shumë se një shkak dhe konkretisht ai pretendon se është diskriminuar për shkak të “*gjendjes arsimore*”, “*bindjeve fetare*” dhe “*përkatësisë familjare*”. Shkaku i diskriminimit është një nga elementët e domosdoshëm për provuar pretendimin për diskriminim. Në radhë të parë shkaku i pretenduar i diskriminimit duhet të jetë një shkak që gëzon mbrojtje nga diskriminimi dhe të radhë të dytë shkaku i pretenduar duhet të provohet.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*” dhe “*bindjet fetare*” Komisioneri gjykon se konsiderohen si shkaqe të mbrojtura, pasi parashikohen si të tilla në nenin 1, të LMD.

“Gjendja arsimore” dhe “bindjet fetare”, përbëjnë gjithashtu shkaqe të mbrojtura nga diskriminimi, sipas Kodit të Punës, i cili parashikon në nenin 9, pika 2 : “Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”

“Gjendja arsimore”, si shkak diskriminim, nënkupton nivelin individual të arsimit, arritjet në arsim, aftësitë, certifikatat dhe mundësitë në lidhje me arsimin, të cilat një person posedon. Diskriminimi për shkak të “gjendjes arsimore”, ka të bëjë me situata kur, gjendja arsimore e palës ankuese, që pretendon se është diskriminuar, bëhet shkak që ajo të dallohet, përjashtohet ose kufizohet, në mënyrë të tillë të pengohet ose të vendoset në kushtet e pamundësisë për të ushtruar të drejtat ose liritë, në rastin konkret të drejtën për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të “gjendjes arsimore” duke parashtruar se ai ka të drejtën ligjore që të ketë orë të plota mësimore, por shkolla ka ulur orët e tij mësimore për të futur në punë një mësues që nuk ka licensën për të ushtruar profesionin sipas ligjit. Ankuesi parashtron se, mësuesi të cilit i kanë kaluar orët mësimore që më parë i përkisnin atij, nuk është i pajisur me licensën përkatëse sipas parashikimeve ligjore dhe nuk ka të drejtë që të punojë si mësues.

Komisioneri vlerëson se, plotësimi nga ana e ankuesit e kushteve ligjore për të ushtruar profesionin e mësuesit nuk presupozon se ai ka të drejtën për të patur një ngarkesë të plotë mësimore dhe ngarkesa mësimore varet nga një sërë faktorësh të tjerë.

Komisioneri konstaton se, “gjendja arsimore” e ankuesit nuk ka shërbyer si shkak për trajtimin e tij të padrejtë dhe të disfavorshëm, pra që orët mësimore të jenë zbritur për shkak të kushteve ose gjendjes arsimore të ankuesit. Marrja në punë nga ana nga ana e shkollës të një mësuesi jo në përputhje me kërkesat ligjore që kërkohen për ushtrimin e këtij profesioni, nuk përbën një pretendim për diskriminim dhe nuk kyn në kompetencat ligjore të Komisionerit, pasi janë institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, ato që duhet të kontrollojnë respektimin e kërkesave ligjore të kësaj natyre. Për rrjedhojë, Komisioneri e vlerëson të pabazuar shkakun e “gjendjes arsimore”.

“Bindja fetare”, që përbën shkakun tjetër të pretenduar të diskriminimit, mbulon shprehjen e besimit fetar ose besimin e zgjedhur nga personi, përfshirë edhe mos pasjen ose mos shprehjen e besimit, të cilat mund të manifestohen privatisht ose publikisht në vende kulti, rite dhe mësimet fetare.

Ankuesi e shtoi shkakun e “*bindjeve fetare*” gjatë kohës që ankesa ishte në proces shqyrtimi . Gjatë seancës dëgjimore ankuesi shpjegoi se, ai ishte besimtar dhe se jo, vetëm ai, por edhe familja e tij, respektojnë besimin dhe ritet e tij, dhe nuk e kuptonte se përse perceptohej nga shkolla si “jo besimtar”.

Sa më sipër, rezulton se pretendimi i ankuesit për diskriminim për shkak të “*bindjeve fetare*” konsiston në faktin që ai pretendon se, orët e tij mësimore janë zbritur pasi ai është perceptuar si “*jo besimtar*” nga Medreseja “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër, e cila është një shkollë fetare e besimit islam.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e mësipërme, Komisioneri arrin në përfundimin se provohet shkakun i pretenduar i diskriminimit “*bindjet fetare*”.

“*Përkatësia familjare*”, nuk parashikohet shprehimisht si shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD. Megjithatë, lista e shkaqeve e parashikuar nga neni 1, i LMD, por edhe neni 9, i Kodit të Punës, nuk është një listë shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “*për çdo shkak tjetër*”.

Në lidhje me shkakun “*përkatësia familjare*”, ankuesi, deklaroi gjatë seancës dëgjimore se, familja e tij ishte një familje e vjetër e qytetit të Shkodrës dhe se ai nuk ishte në gjëndje të jepte shpjegime të tjera në lidhje me shkakun e pretenduar. Komisioneri i vlerëson shpjegimet e ankuesit në lidhje me shkakun “*përkatësia familjare*” të pamjaftueshme për të vlerësuar nëse ky shkak përbën shkak të mbrojtur në kuadër të termit “*për çdo shkak tjetër*”, të parashikuar nga neni 1, I LMD. Për rrjedhojë, Komisioneri e vlerëson të pabazuar shkakun e “*përkatësisë familjare*”.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur “*bindjet fetare*”

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

E drejta për punë dhe mbrojtje nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh, ku parashikohet shprehimisht shkakun i “*bindjeve fetare*”.

KEDNJ-ja, nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8 “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

*Karta Sociale Europiane*⁴ në nenin 1, pika 2, parashikon: “*Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...*” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim⁵. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku parashikohet shprehimisht: “*Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakui të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër*”.

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*⁶, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen vendos detyrimin për të garantuar të drejtën për të mos u privuar nga puna në mënyrë të padrejtë⁷. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar shprehimisht shkakun e besimit fetar.

*Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*⁸ “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh.

Parimi i mosdiskriminimit, përshkon në frymë dhe në nene Kodin e Punës, i cili në pikën 1, të nenit 9, të tij ka përcaktuar se: “*Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohej çdo formë*

⁴ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

⁵ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

⁷ Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

⁸ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar parashikon shprehimisht parimin e barazisë dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.⁹

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁰.

Në të njëjtën frymë edhe në bazë të LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përliqur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹¹ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

⁹ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

¹⁰ Shiko: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

¹¹ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

Në nenin 9/10 të Kodit të Punës dhe nenin 33, pika 7/1, të LMD, barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm.

Në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

Neni 33, pika 7/1 e LMD, ka parashikuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime *“...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara¹²”.*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

¹² GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut/shkaqeve të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun/shkaqet e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëren nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹³

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

- Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm lidhur me zbritjen e orëve mësimore të ankuesit, me shkakun e mbrojtur “bindjet fetare”.

Ankuesi I.B punon pranë Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, Shkodër që prej vitit 2009, ndërsa është bërë bësues definitiv pranë kësaj shkolle në vitin 2015. Rezultoi e provuar gjatë shqyrtimit të ankesës se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak se në fillim të vitit shkollor 2021-2022 i është ulur ngarkesa mësimore nga 18 (tetëmbëdhjetë) orë mësimore në 5 (pesë) orë mësimore, pa një shkak ligjor dhe objektiv. Nga ana tjetër rezultoi që, orët mësimore të cilat i janë zbritur ankuesit i kanë kaluar mësuesit tjetër të edukimit fizik K.H, i cili ka filluar punë si mësues pranë kësaj shkolle në datë 12.11.2019 dhe përgjatë dy viteve të tij të punës në shkollë ka patur një ngarkesë mësimore prej 2 (dy) orë mësimore.

Medreseja deklaroi se ka punësuar mësuesin K.H duke vlerësuar kontributin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm të familjes së tij dhe konkretisht gjyshit të tij, të ndjerit F.H, i cili ka qenë Myftiu i parë i qytetit të Shkodrës. Shkolla deklaroi se, gjyshi i ankuesit Myftiu i parë i qytetit të Shkodrës pas rënies së komunizmit dhe rihapjes së besimit fetar dhe ngritjes së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në vitin 1991 ka qenë nismëtar i themelimit të Medresesë së Shkodrës, medreseja e parë në Shqipëri. Shkolla deklaroi gjithashtu se, në përzgjedhjen e kuadrit mësimor, kriter parësor i performancës është edhe morali islam që ka çdo punonjës dhe se mësuesi K.H i plotësonte këto kritere.

Ankuesi i cili ishte mësues definitiv dhe me një ngarkesë mësimore prej 20 orë mësimore i zbriten ngarkesa mësimore në 5 (pesë) orë mësimore përgjatë vitit shkollor 2021-2022, pa ndonjë shkak të ligjshëm dhe objektiv, duke ia kaluar ngarkesën më të madhe mësimore prej 18 (tetëmbëdhjetë) orë mësimore mësuesit K.H, i cili ka vetëm 2 (dy) vite punë në shkollë, me një ngarkesë prej 2 (dy) orë mësimore dhe që nuk është i pajisur me licensën për të ushtruar profesionin e mësuesit.

Medreseja kundërshtoi pretendimin për diskriminim për shkak të besimit fetar duke argumentuar se, ndryshimi i ngarkesës mësimore dhe zbritja e orëve mësimore të ankuesit nuk është bërë në

¹³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

baza fetare. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Medresesë, deklaruar se, kriteret e marrjes në punë të një mësuesi, bazohen në legjislacionin shqiptar, por ka dhe kriteret që i kërkon donatori dhe në momentin që është punësuar ankuesi në vitin 2009, ai ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara. Shoqata Istanbul, e cila administron dhe financon Medresenë, është një shoqatë islame, fetare dhe Medreseja është një vend ku praktikohet feja ku jepet morali islam. Shkolla menaxhohet me lekë “zeqati” dhe është pa sens që të marrësh njerëz që bien ndesh me bazat e fesë. Aspekti moral islam, ka të bëjë më tepër me filozofinë, se sa një kriter vlerësimi për rekrutim. Ankuesi dhe mësuesi K.H nuk i janë nënshtruar një vlerësimi krahasues, për të vlerësuar se kush është më shumë ose më pak besimtar apo se familja e ankuesit është më e mirë ose më pak e mirë se familja e mësuesit tjetër. Në filozofinë e saj si institucion arsimor i profilit fetar, në varësi të K.M.SH, shkolla ka preferenca të caktuara për personat që kanë prejardhje fetare ose që kanë një arsim të profilit fetar. Megjithatë, për një mësues që nuk është i profilit fetar, mjafton që ai të jetë një profesionist i mirë i profilit të tij dhe të ketë disa parametra njerëzorë moralë, që janë njëkohësisht edhe parametra islam fetarë.

Lidhja shkakësore që duhet të ekzistojë midis trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm dhe shkakut të pretenduar të diskriminimit, në rastin konkret bindjet fetare, është një element i domosdoshëm për të vërtetuar se jemi përpara një sjellje diskriminuese. Pra, është e nevojshme që të vërtetohet nëse trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm i ankuesit dhe zbritja e ngarkesës mësimore ka ardhur si rezultat i bindjeve fetare. Ashtu si edhe çdo element tjetër i diskriminimit, lidhja shkakësore duhet të vërtetohet.

Komisioneri konstaton se, ankuesi ka filluar punë si mësues i edukimit fizik në Medresenë “*Haxhi Shesh Shamia*”, Shkodër në vitin 2009 dhe në vitin 2015 ai është promovuar duke u bërë mësues definitiv. Nga viti 2009 deri në vitin 2021, janë rreth 12 vite që ankuesi punon si mësues në këtë shkollë. Komisioneri vlerëson se, gjatë kësaj kohe, Medreseja, ka patur kohë të mjaftueshme për të vlerësuar përshtatshmërinë e ankuesit me institucionin. Gjatë 12 viteve që ankuesi ka qenë i punësuar si mësues pranë Medrese “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër, është një kohë e konsiderueshme, gjatë të cilës, nëse Medreseja do të kishte patur rezerva apo perceptimin se ankuesi nuk plotësonte performancën në lidhje me “*moralin islam*” ka patur gjithë kohën e nevojshme për të ndërprerë marrëdhënien e punësimit me ankuesin përpara se të punësonte mësuesin K.H apo përpara ndryshimit të ngarkesës mësimore.

Gjatë shqyrtimit të çështjes nuk rezultoi që gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, midis ankuesit dhe Medresesë të ketë patur ngjarje ose rrethana me natyrë ose me kontekst fetar, të cilat mund të kenë penalizuar ankuesin gjatë marrëdhënies së tij me Medresenë, të cilat të mund të ngrenë dyshime se motivet për të cilat është reduktuar ngarkesa mësimore e ankuesit ka për bazë besimin fetar. Ankuesi deklaroi se ai vullnetarisht është angazhuar në aktivitete të ndryshme me natyrë fetare të organizuara nga Medreseja. Nga ana tjetër Medreseja deklaroi se ishte falenderuese për një angazhim të tillë të ankuesit edhe pse një gjë e tillë nuk përbënte detyrim për ankuesin apo mësuesit e tjerë, por edhe se ankuesi ka qenë i favorizuar, pasi ai është lehtësuar që të japë mësim edhe si pedagog në universitet. Fakti që ankuesi ka ushtruar mësimdhënien u deklarua dhe u pranua nga vetë ai, gjatë seancës dëgjimore.

Duke e bazuar pretendimin e tij për diskriminim në faktin se, Medreseja e ka perceptuar atë si “jo besimtar”, ndryshe nga mësuesi K.H me të cilin krahasohet, ankuesi deklaroi gjatë seancës dëgjimore se ai i përkiste besimit mysliman, dhe se, jo vetëm ai, por edhe familja e tij, respektojnë fenë dhe ritualet e saj. Ankuesi deklaroi gjithashtu se, vëllai i tij ishte arsimuar në Medresenë “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër.

Bazuar në përkufizimin ligjor të diskriminimit, duhet që trajtimi i pretenduar si diskriminues të ketë ardhur si rezultat i një shkakut të mbrojtur, shkak të cilin personi me të cilin ankuesi krahasohet, nuk e ka. Rezultoi e provuar në bazë të deklarimeve të bëra nga ankuesi gjatë seancës dëgjimore se, ai ka të njëjtën përkatësi fetare sikurse krahasuesi, mësuesi K.H dhe se gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk u konstatua asnjë fakt ose rrethanë mbi bazën e të cilës mund të mund të lindnin dyshime se, Medreseja ka patur një vlerësim apo një perceptim të ankuesit si “jo besimtar”.

Komisioneri arrin në përfundimin se, bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk rezultoi e provuar që trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi nëpërmjet uljes së ngarkesës mësimore nga ana e Medresesë “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër të jetë pasojë e drejtëpërdrejtë e shkakut të pretenduar të diskriminimit “bindjeve fetare” dhe se lidhja shkakësore nuk provohet. Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit “*bindjet fetare*”, nuk mund të çojnë *a priori* në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk provohet lidhja shkakësore, pra arsyeja për diferencën në trajtim, është shkak i pretenduar i diskriminimit.

Komisioneri thekson se, një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme përbën diskriminim. Për të arritur në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm të cilit i është nënshtruar subjekti përbën diskriminim, duhet të përmbushen dhe provohen kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se pretendimi i ankuesit I.B, se ulja e orëve të tij mësimore ka ardhur si pasojë e “bindjeve fetare”, nuk është i bazuar dhe rrjedhimisht nuk konstatohet se Medreseja “*Haxhi Shesh Shamia*” Shkodër e ka diskriminuar ankuesin për shkak të “bindjeve fetare”, në lidhje me uljen e orëve mësimore.

- **Në lidhje me moskalimin e orëve të lira mësimore të edukimit fizik, pas largimit nga puna të mësuesit K.H.**

Bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se:

- ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të disfavorshëm, duke mos i kaluar ngarkesën mësimore prej 18 orë të lira mësimore të edukimit fizik, pas largimit të mësuesit K.H;
- orët e lira mësimore të edukimit fizik pas largimit të mësuesit K.H i kanë kaluar një punonjësi i cili nuk është i profilit të edukimit fizik, ndërkohë që ankuesi ishte i vetmi mësues i edukimit fizik në shkollë dhe me një ngarkesë të ulët të orëve mësimore;

- kalimi i orëve të lira mësimore është bërë në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e arsimit parauniversitar, sipas të cilit kërkohet që lëndët mësimore të jepen nga mësues të profilin ose të një profili të përafërt sipas përcaktive në aktet respektive;
- moskalimi i orëve mësimore sjell pasojë të pavaforshme për ankuesin në lidhje me pagën që do të përfitonte po të kishte numër më të lartë të orëve mësimore por edhe në raport me vazhdueshmërinë e marrëdhënies së punës, e cila kushtëzohet nga ngarkesa mësimore që ka një mësues.
- ankuesi ka paraqitur ankesën në datën 17.01.2022 ndërsa pasojat e disfavorshme që i kanë ardhur, nëpërmjet moskalimit të orëve të lira mësimore të edukimit fizik pas largimit të mësuesit K.H kanë ardhur pas datës 15.02.2022, datë në të cilën është larguar mësuesi K.H;
- Medreseja “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër ka marrë dijeni për ankesën për diskriminim, të paraqitur nga ankuesi në datën 05.02.2022, bazuar në njoftimin e realizuar nga Komisioneri me shkresën nr.118/1 prot., datë 03.02.2022;

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se krijohet prezumimi se, moskalimi i orëve të lira mësimore të edukimit fizik pas largimit të mësuesit K.H, është pasojë negative që ka ardhur si rezultat i paraqitjes nga ana e ankuesit të ankesës për diskriminim kundër Medresesë “*Haxhi Sheh Shamia*” Shkodër, pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 33, pika 7/1, të LMD Medreseja, kishte barrën e provës që të provonte se trajtimi i disfavorshëm dhe moskalimi i orëve të lira mësimore tek ankuesi, nuk është bërë për shkak të ankimit për diskriminim që ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit, ose që një sjellje dhe një veprim i tillë nga ana e Medresesë, ka ndodhur në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se orët e lira mësimore nuk i janë dhënë atij për shkak të ankesës për diskriminim para Komisionerit.

Në lidhje me arsyen se, përse orët e lira nuk i kishin kaluar ankuesit, i cili ishte i vetmi mësues mësuesi i profilin në shkollë dhe me ngarkesë të ulët të orëve mësimore (5 orë mësimore), z.F.D, Kordinator i Shoqatës Istanbul pranë Medresesë, në cilësinë e përfaqësuesit të Medresesë, deklaroi gjatë seancës dëgjimore se, kjo gjë kishte ndodhur pasi në datën 17 janar, nga ana e ankuesit ishte bërë një ankesë dhe një gjë e tillë është parë si një lloj krisje e marrëdhënieve midis ankuesit dhe shkollës. Ndërsa, përfaqësuesi tjetër i Medresesë, z. R.S, Kryetar i Shoqatës Istanbul, deklaroi gjatë seancës dëgjimore se, kur kanë marrë dijeni për ankesën, janë ndjerë se është bërë pabesisht nga ankuesi, pasi kanë mendur se palët janë dakortësuar me kushtet e reja të punës edhe pse nuk kishin nënshkruar kontratën e re.

Bazuar në deklaratimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, provohet plotësisht se vendimi i medresesë për të mos i kaluar orët e lira mësimore ankuesit ka ardhur si rezultat i paraqitjes së ankesës për diskriminim pranë Komisionerit. Në këtë mënyrë vërtetohet lidhja shkakësore, pra që trajtimi i disfavorshëm është pasojë e drejtëpërdrejtë që ka ardhur si pasojë e ankesës për diskriminim të paraqitur nga ankuesi pranë Komisionerit.

Në nenin 3, pika 17, të LMD, parashikohet : “17. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.”

Në nenin 5, pika 1, të LMD, parashikohet se: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.”

Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi LB është diskriminuar nga ana e Shkollës Jopublike Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër, duke u viktimizuar, si pasojë e paraqitjes pranë Komisionerit të ankesës për shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit. Për rrjedhojë Shkolla Jopublike Medreseja “Haxhi Sheh Shamia” Shkodër, ka shkelur ndalimin e diskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 3, pikat 1 e 17 dhe nenit 5, pika 1, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa në nenin 33, pika 12, përcaktohet se : “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

LMD, në nenin 33/10, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktime të diskriminimit. Ky ligj, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, për rregullimin e situatës diskriminuese të konstatuar, Shkolla Jopublike Medreseja “Haxhi Shesh Shamia” Shkodër, duhet të marrë masa që orët mësimore të shpërndahen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe të jepen nga mësues të profilit përkatës dhe që situata të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankuesit I.B, në lidhje me moskalimin e orëve të lira mësimore ankuesit, pas largimit të mësuesit K.H, nga ana e Shkollës Jopublike Medrese “*Haxhi Shesh Shamia*” Shkodër.
2. Shkolla Jopublike Medreseja “*Haxhi Shesh Shamia*” Shkodër, duhet të marrë masa që orët mësimore të shpërndahen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe të jepen nga mësues të profilit përkatës.
3. Shkolla Jopublike Medreseja “*Haxhi Shesh Shamia*” Shkodër, duhet të marrë masa që të mos përsëriten në të ardhmen situata të tilla diskriminuese.
4. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit I.B, për shkak të “*bindjeve fetare*”, nga ana e Shkollës Jopublike Medreseja “*Haxhi Shesh Shamia*” Shkodër, në lidhje me uljen e orëve mësimore në fillim të vitit shkollor 2021-2022.
5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Shkolla Jopublike Medreseja “*Haxhi Shesh Shamia*” Shkodër, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet fetare
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Diskriminim në formën e viktimizimit
Mosdiskriminim.
Forma: Diskriminim në form